
Etika
për fëmijë
Dhuratë e përmuajshme, nga revista "Etika"
Viti 4 - Numri 39 - Mars 2014
DITURIA
ËSHTË THESAR...

# Tre armiqtë e suksesit

**Mustafa Jazgan**

Fëmijë të dashur! Ju jeni shpresa, e ardhmja dhe krenaria jonë!

Qëllimi kryesor i kësaj bisede është që t'ju ndihmoj ju të jeni të suksesshëm. Sepse suksesi duhet të jetë qëllimi i vetëm i secilit nga ne.

Do të flasim për tri gjërat kryesore, që bëhen pengesë në rrugën e suksesit.

- Armiku kryesor i suksesit është dembelizmi. Shejtani e mashtron pa pushim njeriun dhe e bën atë që të jetë i papërgjegjshëm, egoist dhe i dhënë pas qejfeve të kësaj bote. Ky njeri i shkëput lidhjet me familjen, shkollën, mësuesit, të afërmit dhe shokët. Ai fillon të humbasë edhe respektin, edhe dashurinë.

Marrëdhëniet mes njerëzve na diktojnë disa të drejta dhe disa përgjegjësi. Njeriu që nuk i respekton këto të dyja do të jetë përfitues, egoist dhe me moral jo të mirë. Ky njeri do të përjashtohet nga shoqëria, sepse askush nuk dëshiron që të ketë të bëjë me njerëz të tillë.

Dembelizmi mund të jetë një sëmundje, që lind nga një problem psikologjik ose biologjik. Në qoftë se shkaktohet nga faktorë psikologjikë, ne mund ta luftojmë me anë të një arsyeje të fortë. Në qoftë se shkaktohet nga probleme biologjike, duhet të





këshillohemi me një mjek specialist. Edhe adhurimet na ndihmojnë në një rast të tillë. Kjo është mënyra më e mirë për të luftuar me armikun e parë të suksesit.

- Armiku i dytë është shoqëria e keqe. Kërkoni mbrojtje tek Allahu nga shokët e llastuar, të paedukatë, arrogantë, të padisiplinuar dhe që përdorin fjalor të papërshtatshëm. Duhet të keni kujdes, sepse ai nuk do t'jua tregojë fytyrën e vërtetë asnjëherë. Ai do t'u afrohet me dashuri të rreme dhe do t'ju duket si një shok që i ndihmon të tjerët dhe që gjithmonë mundohet t'i bëjë të lumtur njerëzit përreth. Ai do t'iu mashtrojë ju me buzëqeshje të rreme.

Dembelizmi vetë, nganjëherë, lind nga bisedat me shokët e këqij. Këta tipa njerëzish shqetësohen, kur shikojnë fëmijë punëtorë dhe të suksesshëm. Ato tallen me vullnetin për punë, sepse janë xheloz.

- Armiku i tretë i suksesit është: "shembulli negativ"... Këta shembuj jepen nga njerëz, që nuk e arrijnë dot suksesin me dituri, besim, drejtësi, punë dhe nder. Ata tentojnë të bëhen të suksesshëm duke përdorur hile, mashtrime dhe vjedhje. Këta njerëz përdorin çdo rrugë për të fituar famë, pasuri dhe sukses. Një njeri që mendon se suksesi fitohet me mashtrime është i humbur. Ju lutem fëmijë të dashur, bëni shumë kujdes!..

Etika për fëmijë

Drejtor
**Albert Halili**
+355 67 60 78484

Kryeredaktor:
**Alban Kali**
+355 69 24 23989

Redaktor:
**Xhahid Bushati**
xhahidbushati@yahoo.com
+355 69 28 20 975

Redaktor gjuhësore:
**Zija Vukaj**

Përkthyes:
**Ernida Kraja**
**Naile Sulaj**

Dizajn - Grafik:
**Bledar Xama**
bledar_xama@hotmail.com

**Adresa:** L: Vasil Shanto - Rr: Çajupi - Shkodër - Albania / Tel: +355 22 254 634 / Fax: +355 22 254 633
**Zyra e përfaqësimit Maqedoni:** Rr: Stiv Naumov - Nr. 9 - lokal 25 - Shkup - Maqedoni / Tel: +389 71 956 271
**Zyra e përfaqësimit Kosovë:** Rr: Ardian Zurnaxhiu - pn. Ralin - Prizren - Kosovë / Tel: +381 29 222 795

# KËNGË VJOLLCASH

**Agim Deva**

Çupëza Vjollcë me babin në mal,
Te një vjollcë e vogël gëzueshëm u ndal…
-A e sheh se emrat i kemi njësoj,
Këtë, lulushë e bukur, vërtetë s'e kuptoj!
Ti vjollcë në mal – unë Vjollcë në qytet,
Por me emër t'njëjtë tërë bota na thërret!
-Paj, mes nesh, moj çupëz, shumë dallime s'ka,
Pos që t'shkruhet emri me shkronja të mëdha!
Dallim tjetër, Vjollcë, nuk shoh që të ketë,
Ty të puth një nënëz, mua m'puth një bletë;
Ti udhëton me këmbë e unë me dëshira,
Për të dyja sot erdhën kohë të mira…
E kur vjen Tetë marsi zemrën ta kuptoj,
N'dorë t'bëhem – dhuratë që nënën ta gëzoj.
N'hije Vjollca vjollcës i merr pakëz erë,
Njëra tjetrës n'mal sikur i bëjnë ndër,
Duket do të ndahen sot pa e kuptuar,
Cila cilës emrin ia ka huazuar…
Tekefundit, kjo rëndësi nuk ka,
T'dy vjollcat le t'nisen me shkronja të mëdha,
Nëse gramatika këtë nuk e lejon –
E lejojnë dy vjollcat e kjo – na mjafton…


Adelina R. Mamaqi

# NJË LIBËR I BUKUR

Me dritare i bëjmë shtëpitë
Të kenë ajër e diell e dritë!

Po te libri i bukur, me fletë,
A e di, vogëlush, ç'mund të ketë?

Ai ka mbi njëmijë dritare,
Të shikosh gjithë botën e madhe!




# "VIZATIMET" E JETËS SONË

**Hymejra Karagëz**

Miq të dashur, ju e dini shumë mirë se pjesa më e madhe e jetës sonë kalon përpara televizionit. Fatkeqësisht ajo kuti magjike na ka sjellë gjëra pozitive, por edhe shumë negative. Në këtë shkrim kam dëshirë të flas me ju për filmat vizatimorë.

Filmat vizatimorë ose siç quhen ndryshe: 'cartanat' janë shumë të dobishëm për zhvillimin normal të një fëmije. Ato ju çojnë drejt një bote tjetër. Heronjtë e tyre ju tërheqin nga një aventurë në tjetrën.

Filmat vizatimorë që shikohen me kujdes dhe kuptohen nga fëmijët, ndikojnë shumë në botën e tyre të brendshme. Sepse bota e njeriut fillon të formohet që në moshë të hershme. Mendoni një fletë të bardhë. Ju mund të vizatoni një pikturë të bukur dhe të qeshur, ju mund të hidhni në letër gjëra të ndryshme, të cilat i shikoni gjatë jetës suaj. Në të njëjtën kohë, ju mund të pikturoni gjëra të frikshme dhe të shëmtuara. Mund të vizatoni gjëra që i trembin njerëzit e tjerë.



Specialistët e krahasojnë botën tonë të brendshme me këtë fletë boshe. Kjo fletë që është krejt e bardhë kur lindim, me kalimin e kohës mund të mbushet me gjëra të bukura ose të shëmtuara. Në qoftë se shikojmë vetëm emisione dhe filma, të cilat përmbajnë skena dhune dhe egoizmi, fleta jonë e pastër do të ndotet me piktura të shëmtuara. Ndërsa filmat me tema miqësie, dashurie dhe lumturie të vërtetë e zbukurojnë fletën tonë.

Nuk duhet të harrojmë që pjesa më e madhe e filmave vizatimorë që fëmijët tanë shikojnë janë prodhim i huaj. Për këtë arsye, këto 'cartana' nuk përshtaten aspak me kulturën dhe mënyrën tonë të jetesës. Edhe në programet më të thjeshta dhe të bukura ka skena që mund të ndikojnë për keq tek fëmija. Sigurisht që unë nuk po ju kërkoj që të mos i shikoni kategorikisht, por thjesht ju kërkoj që të jeni të kujdesshëm. Shikoni filmat vizatimorë duke marrë parasysh kulturën dhe botëkuptimin tonë.

Dëshiroj t'u jap një shembull të një filmi vizatimor që pashë kohët e fundit. Sa shumë bëjmë përpjekje që ne të besojmë në ekzistencën e babagjyshit të vitit të ri! Njerëzit që shikojnë filmin vizatimor për të cilin po ju flas, edhe nëse nuk i besojnë aspak ekzistencës së babagjyshit, fillojnë të kenë një dyshim të vogël në lidhje me këtë çështje. Sigurisht


që fëmijët janë më të lehtë për t'u bindur në këtë gjë.

Po ju jap edhe një shembull tjetër. Në shumë prej filmave vizatimorë shohim heronj që kanë super- fuqi. Personazhi që ka super-fuqi është më i miri dhe më i dashuri nga të gjithë. Por në besimin tonë, fuqia e çdo njeriu ka një kufi. Allahu është më i Fuqishmi dhe fuqia e Tij nuk ka asnjë kufi. Këto lloj filmash vizatimorë kanë për qëllim t'i bëjnë fëmijët që ta harrojnë këtë të vërtetë absolute. Ndaj, këta fëmijë kur i shikojnë këto filma vizatimorë, fillojnë të sillen sikur të jenë më të fortit e universit. Ato imitojnë heronjtë e fuqishëm si : njeriu-merimangë, Batman, Superman. Fëmijë të dashur ne jemi njerëz të thjeshtë dhe sado që të jemi të fuqishëm, mos të harrojmë se Krijuesi ynë është më i fuqishëm se çdokush dhe çdo gjë. Mos e harroni asnjëherë këtë gjë!

Duhet të pranojmë që ekzistojnë edhe shumë filma vizatimorë, të cilët janë të dobishëm për zhvillimin tuaj mendor dhe shpirtëror. Ato filma do t'iu argëtojnë, dhe në të njëjtën kohë do t'iu mësojnë gjëra të reja. Gjëja më e rëndësishme është që të bëni kujdes me gjërat që shikoni. Duhet të zgjidhni filma vizatimorë që mund t'iu mësojnë diçka, jo filma që përmbajnë vetëm dhunë, armë dhe grindje. Ju duhet të shikoni programe dhe filma, të cilat përshtaten me kulturën tonë. Për shembull: mund të shikoni programe që propagandojnë miqësinë, dashurinë e sinqertë, punën në grup, tolerancën dhe ndihmën për të tjerët.

Po prindërit tuaj, a i shikojnë filmat vizatimorë? Mbase ata mund t'ju ndihmojnë për të zgjedhur filmat dhe programet që duhet të shikoni. Pse nuk i ftoni edhe ato, që të shikoni së bashku televizion? Ato do t'iu tregojnë se çfarë të shikoni, dhe nga ana tjetër ju do të shijoni lumturinë e të ndarit gjëra me prindërit tuaj.

Uroj që jeta juaj të mbushet vërtet me 'vizatime' të bukura..!



# HISTORIA E TREGUAR NGA PEJGAMBERI YNË

## TULLACI, I VERBËRI DHE I SËMURI LEBROZ

**Emine Tashgetiren**

Mendoni një çast, të dashur fëmijë se jeni në provim dhe ju thyhet maja e lapsit. E holloni lapsin dhe ju thyhet përsëri. E provoni edhe njëherë, por përsëri thyhet. Shoku juaj ka 3-4 lapsa dhe ju i kërkoni një laps. Ai nuk jua jep. Çfarë ndjeni?

Keni humbur paratë tuaja në shkollë. Nuk keni lekë që të ktheheni në shtëpi. I kërkoni borxh një shokut tuaj, por nuk jua jep. Çfarë ndjeni?

Gjatë ndeshjes jeni rrëzuar. Jeni mbuluar me baltë. Nuk keni rroba rezervë me vete. Nuk keni se si t'i mbani veshur ato rroba gjithë baltë. Mendoni t'i kërkoni ndihmë shokut tuaj Enes, që është gjithmonë i kujdesshëm në marrjen e masave paraprake. A do t'ju ndihmojë vallë? Po sikur t'ju thotë: 'E çfarë do të ndodh nëse bie edhe unë në baltë?' Gjithsesi nuk mund t'i mbani veshur ato rroba, prandaj mblidhni gjithë guximin dhe shkoni pranë shokut tuaj. Përgjigjja e tij është e menjëhershme: "Çfarë është ajo fjalë, ja merri, ndërroju menjëherë!" Çfarë ndjeni?.. Kjo do të jetë një nga ato skenat që nuk do t'i harroni asnjëherë. Nuk do ta harroni kurrë zemërgjerësinë e këtij shoku të dashur. Ai ju ka lumturuar aq shumë, sa do ta kujtoni gjithmonë në Dua...

Të dashur fëmijë, pse vallë jua tregova këto gjëra? Jam emocionuar shumë nga një hadith që kam lexuar. Ne e hasim shumë shpesh në jetën tonë ngjarjen, që tregohet në hadith. Çdo veprim që bëjmë na jep pikë pozitive ose negative. Pra, ose marrim sevape ose gjynahe. Si ndodh kjo?

Ja ta lexojmë së bashku hadithin dhe pastaj do ta kuptoni.

Ngjarja që tregon hadithi është:

Ebu Hurejra (r.a.), ka transmetuar këto fjalë të Pejgamberit (a.s.):

"Mes bijve të Israelit ndodheshin tre njerëz, njëri ishte me lebrozë, njëri ishte i verbër, ndërsa tjetri ishte tullac. Allahu donte t'i sprovonte, prandaj u dërgoi një ëngjëll.

Meleku i tha njeriut me lebrozë:

"Cila është dëshira jote më e madhe?

"Një ngjyrë e bukur, një lëkurë e bukur dhe largimin e kësaj sëmundjeje që i bën njerëzit të më kenë neveri."- iu përgjigj ai.

Meleku e preku burrin dhe sëmundja iu largua. Më pas meleku e pyeti përsëri:

"Çfarë ke dëshirë që të kesh?"

"Deve."

Meleku i dha një deve që ishte shtatzënë dhe bëri Dua: "Allahu e bëftë të begatë devenë tënde!" - Më pas e pyeti burrin tullac:

"Cila është dëshira jote më e madhe?"

"Do të doja të kisha flokë të bukur dhe largimin e këtij tullacllëku."

Meleku e preku në kokë dhe burrit i dolën flokë të bukura dhe të shkëlqyeshme. Meleku e pyeti përsëri:



"Çfarë ke dëshirë që të kesh?"

"Një lopë" –iu përgjigj burri.

Meleku i dha një lopë shtatzënë. E uroi burrin me fjalët: "Allahu e bëftë të begatë lopën tënde.", - dhe shkoi tek burri i verbër. E pyeti atë:

"Cila është dëshira jote më e madhe?

"Unë do të doja që Allahu të ma kthente shikimin, në mënyrë që të kisha mundësi të shikoja njerëzit."

Meleku i preku sytë e tij dhe me lejen e Allahut atij iu kthye shikimi. Më pas e pyeti:

"Çfarë ke dëshirë që të kesh?"

"Dele"- iu përgjigj burri.

Meleku i dha një dele shtatzënë. Deveja, lopa dhe delja i lindën të vegjlit e tyre dhe u shumuan. Njëri burrë u bë me një tufë delesh, tjetri me deve dhe tjetri me lopë.

Një ditë meleku shkoi tek burri që kishte qenë me lebrozë dhe i tha:

- Jam shumë i varfër dhe nuk kam para për të shkuar në një vend ku më duhet të shkoj. Kam nevojë për ndihmën tënde. Në emër të Allahut që të ka dhënë një lëkurë kaq të bukur dhe të shndritshme, më ndihmo! Unë kam nevojë për një deve, që të kryej udhëtimin tim.

- Eh sa shumë njerëz kanë nevojë për para e për deve, - u përgjigj burri.

- Më duket sikur të njoh. A nuk ke qenë ti ai burri prej të cilit neveriteshin njerëzit? A nuk ke qenë i sëmurë me lebrozë? Ti ke qenë i varfër, por Allahu të dha pasuri...

- Këtë pasuri e kam trashëguar nga të parët e mi, - i tha burri.

- Në qoftë se je duke gënjyer, Allahu të ktheftë në gjendjen e mëparshme, - ia ktheu meleku.



Më pas meleku shkoi tek njeriu që kishte qenë tullac dhe i tha ato që i kishte thënë edhe burrit me lebrozë. Edhe ai iu përgjigj në të njëjtën mënyrë.

- Në qoftë se je duke gënjyer, Allahu të ktheftë në gjendjen e mëparshme, - ia ktheu meleku.

Këtë herë meleku u nis drejt njeriut që kishte qenë i verbër. E gjeti atë dhe i tha:

- Jam udhëtar dhe jam shumë i varfër. Nuk kam mundësi që të vazhdoj rrugën time. Të kërkoj ndihmë, në emër të Allahut që të ka kthyer shikimin. Të lutem më ndihmo që të vazhdoj rrugën time!

Burri iu përgjigj me këto fjalë:

- Me të vërtetë unë kam qenë i verbër dhe Allahu ma ktheu shikimin. Merr çfarë të duash nga pasuria ime dhe të betohem që ta fal, nuk të kërkoj të ma kthesh.

- Pasuria jote qoftë e jotja. Kjo ishte një sprovë për ty. Allahu është i kënaqur prej teje. Ai i dënoi shokët e tu, duke ua kthyer sëmundjet që kishin pasur, - i tha meleku dhe u largua prej aty.

Të dashur fëmijë, më duket sikur ju dëgjoj teksa pëshpëritni : 'Sa mirë bëri i verbëri që e ndihmoi udhëtarin!.. Ah, sikur ta kishin ndihmuar edhe të tjerët'. Tashmë unë jam e sigurt që kur dikush do t'iu kërkojë diçka, ju nuk do t'ia refuzoni ndihmën. Mos harroni që, diçka e dhënë, sado e vogël, e ndihmon shokun që të dal nga vështirësia dhe e qetëson atë. Ju e lumturoni shokun tuaj me anë të ndihmës që i jepni. Në fund të fundit, jeni ju që fitoni sevape, dhe bëheni shkak që melekët të luten për ju me fjalët: "O Allahu im, jepi më shumë këtij robit tënd që është kaq bujar..." Kur ju ndihmoni të tjerët, Allahu është i kënaqur nga ju. Mos të harrojmë që asgjë nuk është e jona, ne mund të dhurojmë vetëm nga pasuria që na ka dhënë neve Allahu...

Qofshi amanet i Zotit, ju o miqtë e mi të vegjël që nuk ia kurseni ndihmën miqve tuaj...

# ËNDRRA E NJË FËMIJE

Hysejin Shekerxhiler


Një fëmijë mbeti i mahnitur nga bukuria e një guri të sheshtë, që ishte në breg të detit. Mendoi se guri ishte i çmuar. Edhe formën e kishte si të zemrës së njeriut. Mbi të gjitha shkëlqente shumë.

Djali e mori gurin dhe vrapoi për në shtëpi. Me një emocion të madh ia tregoi babait. Babai e kuptoi menjëherë se guri që mbante djali në dorën e mavijosur nga i ftohti, nuk ishte gjë tjetër veçse një gur i zakonshëm, por këtë nuk mundi t'ia thoshte...

Djali i vogël dëshironte të blinte një biçikletë. Atë e shikonte çdo natë në ëndërr. Mendoi ta shiste gurin. Besonte se do t'i tepronin edhe ca para. Me to do të blinte edhe një top. Babai nuk kishte të njëjtin mendimin me të.


Kur djali kuptoi se kjo punë, tashmë, kishte mbetur në dorën e tij, gjatë pushimit shkoi në treg. Vitrinat e argjendarive ishin të mbushura plot me varëse floriri, që të magjepsnin me shkëlqimin e tyre. Kishte edhe unaza të shtrenjta me gurë shumë më të vegjël se ai që djali mbante në dorë.

Djali shëtiti sa shëtit, pastaj i vuri syrin dyqanit më të bukur të tregut. Priti pak para vitrinës. Brenda në dyqan ishte një zotëri, i cili dukej se ishte pronari teksa bisedonte me një kliente.



Djali i vogël hyri brenda. I zgjati shitësit, gurin që nxori nga xhepi, dhe i tha:

"Këtë diamant e gjeta në breg të detit. Nëse dëshironi, jua shes."



Burri e pa nga larg gurin dhe tha: "Ai është vetëm një gur i zakonshëm. I gjithë bregdeti është i mbushur me gurë të tillë." "Jo!" - u hodh e tha djali i vogël. Po deshët, lageni dhe do të shihni se sa shkëlqen!..

Gruaja që ndodhej aty, e kuptoi qëllimin e djalit. Ajo e mori gurin në dorë, e pa disa herë nga afër, tundi kokën dhe i tha djalit me një buzëqeshje nëne: "Pikërisht, ky është guri që po kërkoja. A mund të ma shesësh mua?"

Djali ishte shumë i lumtur që më në fund gjeti dikë, që e kuptoi vlerën e atij guri. Ndërsa paratë që i mbushën xhepin, ia morën mendjen. Pasi e falënderoi disa herë gruan, u largua i lumtur.



Pronari i dyqanit mendonte se gruaja ishte mashtruar dhe nuk i kishte kuptuar këshillat e tij. I çuditur i tha: "E thashë edhe më parë, por po e përsëris, ai, që sapo keni blerë është vetëm një gur, një gur i thjeshtë."

Gruaja pa njëherë nga varësja, pastaj nga unaza dhe iu përgjigj: "Aspak!.. Për mendimin tim ai gur është më i vlefshëm se këto, sepse mbart ëndrrën e një fëmije."



# Çfarë Si Përse?

Zehra Aksoy



## Përse i ngrijmë ushqimet në frigorifer?

Ushqimet që i përdorim çdo ditë, i fusim në pjesën e poshtme të frigoriferit. Ndërsa ato që duam t'i ruajmë për një kohë të gjatë, i fusim në pjesën e ngrirjes. Shkaku i prishjes së ushqimeve në temperaturë normale është se në këto kushte bakteriet, mikrobet ose thënë më shkurt mikroorganizmat zhvillohen, dhe në këtë mënyrë vazhdojnë ta kryejnë aktivitetin e tyre. Ndërsa në temperaturë të ulët këto mikroorganizma nuk mund të jetojnë dhe në këtë mënyrë prishja e ushqimeve nuk realizohet.

## Ku bie më shumë rrufeja (shkrepëtima)?

Rrufeja zakonisht bie në vende të larta e të mprehta si: antena, shtylla telefoni, linja të larta, minare, pemë të larta e shkëmbinj... Për këtë arsye në kohë me shi e shkrepëtima duhet të qëndrojmë larg këtyre vendeve e pikave, në të cilat ka më shumë mundësi të bie rufeja.





## A ka dobi djersitja?

Djersitja është shumë e rëndësishme për trupin. Me anë të djersitjes trupi nxjerr jashtë lëndët e dëmshme helmuese dhe ruan ngrohtësinë. Mund të themi se djersitja, duke treguar efekte të ngjashme me kondicionerin, e freskon trupin. Nëse nuk do të kishim djersitur, trupi nuk do të mund ta kishte ruajtur temperaturën e tij normale, e cila është afërsisht 37 gradë, ndryshe temperatura trupore vazhdimisht do të rritej dhe trupi do të nxehej. Atëherë jeta jonë do të vihej në rrezik.





# ARTI NË SHPIRTIN TIM

**Ditmar Hoti**

Arti është një gjë e bukur për syrin, mendjen dhe shpirtin. Ai i bën njerëzit të ndihen ndryshe, të shprehen në forma të ndryshme dhe të veprojnë në larmi mënyrash. E rëndësishme është se arti që ato shprehin t'i bëjë unikë.

Nga artet më shumë pëlqej muzikën dhe pikturën, sepse ato ndikojnë pozitivisht tek unë duke më bërë të ndjej paqe e qetësi. Më duket sikur jam në një botë magjike, e cila krijohet dhe drejtohet vetëm nga unë.

Nuk e besoja se lidhja e pikturës me muzikën do të më sillte një përzierje mendimesh, të cilat do të reflektoheshin në pikturat e mia dhe jo vetëm kaq, por edhe piktura të ndikonte në përzgjedhjen e muzikës.

Kur unë pikturoj një natyrë të qetë, dua që muzika të jetë e qetë dhe të mos ndikojë në përqendrimin tim, që ajo të dalë sa më bukur dhe mendimet e mia të jenë të shprehura sa më qartë. Ndërsa, kur pikturoj një pikturë abstrakte me një mori ngjyrash, unë zgjedh një këngë të fortë dhe ritmike.

Mendoj se arti e bën një njeri të ndihet ndryshe dhe ta shikojë botën shumëngjyrëshe, plot gjallëri e plot jetë. Shpirti i artistit është unik, me ide gjeniale, që nuk shterojnë, por ripërtërihen dita – ditës. Uroj që një ditë të ndihem i tillë, që arti të depërtojë thellë në shpirtin tim…



piktura e parë, 2011

**Mete Ullusoj**

# ELEFANTI

Elefanti është kafsha më e madhe që jeton në tokë. Jeton kryesisht në kontinentin e Azisë dhe të Afrikës. Elefantët e Afrikës dallohen prej elefantëve të Azisë, sepse kanë veshë të mëdhenj dhe janë nga trupi më të mëdhenj. Gjatësia e tyre arrin deri në 3-4 metra, ndërsa pesha luhatet mes 4-12 ton.

Elefanti e kalon pjesën më të madhe të kohës duke u ushqyer. Në ditë ai ha 225 kg bar dhe pi rreth 200 litra ujë. Mesatarisht elefanti harxhon 16 orë në ditë duke ngrënë.

Feçka e elefantit është si një hundë e gjatë që shërben për të marrë frymë, për të nuhatur, për të nxjerr zë, për të pirë ujë dhe për të mbajtur ushqimet. Feçka ka rreth 100 mijë muskuj. Në moment nevoje ajo shtrëngohet dhe ka fuqi që të shtyjë edhe një pemë me peshë shumë të madhe. Nga ana tjetër feçka është aq e ndjeshme sa mund të këpus nga dega edhe kokrrat e vogla të bizeles dhe t'i marr në gojë.

Elefanti ushqehet me ndihmën e feçkës. Ai e merr ushqimin me anë të saj dhe e çon në gojë. Gjithashtu ai pi ujë me anë të feçkës. Elefanti mund të marr deri në 14 litra ujë me anë të feçkës. Elefantët e duan ujin dhe larjen. E marrin ujin me feçkë dhe e hedhin sipër vetes.

Dhëmbët e elefantëve janë shumë të çmuar dhe njerëzit që e dinë këtë gjë, fatkeqësisht i vrasin elefantët vetëm për këtë arsye. Për momentin tregtia e dhëmbëve të elefantëve është e ndaluar me ligj, por ka raste që vazhdohet në mënyrë të jashtëligjshme. Vrasja e elefantëve mund të bëhet shkak për zhdukjen e disa specieve.

Foshnja e sapolindur mbrohet dhe edukohet nga nëna e vet. Elefantët femra jetojnë në grupe. Vetë grupi jep ndihmën e vet në edukimin e elefantit të vogël. Një elefant jetim birësohet nga një femër elefante, e cila kujdeset për të si të ishte fëmija i vet.

Elefanti ka këmbë shumë të fuqishme, që ngjasojnë me shtylla të mëdha, kjo është e domosdoshme duke marrë parasysh masën e tyre të madhe. Këto këmbë të fuqishme bëjnë që elefanti të qëndrojë në këmbë për një kohë shumë të gjatë. Elefantët radhë herë rrëzohen në tokë. Kjo mund të ndodhë vetëm në rastin e një sëmundje apo nga një plagosje.



Jetëgjatësia e elefantit varion nga 50 deri në 70 vite. Elefanti më jetëgjatë deri në ditët e sotme është elefanti që jetoi 82 vite.



Elefantët notojnë mirë, por nuk mund të kërcejnë.

Janë kafshë barngrënëse. Ushqimet më të preferuara të tyre janë: rrënjët e pemëve, bimët, frutat, etj.



Në kopshtet zoologjike të Evropës gjenden rreth 1200 elefantë. Jetëgjatësia e këtyre elefantëve që jetojnë larg kushteve natyrore është sa gjysma e jetëgjatësisë së elefantëve në Afrikë.

Veshët e elefantëve të Afrikës janë mjaft të mëdhenj. Kur kanë të nxehtë, arrijnë të freskohen duke tundur veshët.

Shtatzënia e një elefanti-femër zgjat 22 muaj. Një elefant i sapolindur peshon rreth 120 kg dhe është i gjatë 1 metër.

Në Azi, elefantët vazhdojnë të përdoren si kafshë transporti. Në kohët e vjetra ato janë përdorur edhe si kafshë lufte.



# THESARI

**Shule Tuxhu**

Aliu, si gjithmonë, ishte ulur në një cep dhe po thurte imagjinata... Ishte një fëmijë ëndërrimtar. Nuk mund ta ndalte as koha, as vendi ku nodhej. Për të nuk kishte rëndësi nëse qëndronte poshtë një peme, apo ishte i ulur në divan. Ai vetëm ëndërronte...

Ditët e fundit e kishte tepruar me gjendjen e tij. Vazhdimisht ëndërronte dhe nuk merrej me asgjë tjetër. Meqë edhe shkolla ishte pushim, ai bënte pushim sipas mendjes së tij. E kalonte kohën ashtu kot pa bërë asnjërën nga punët, që i takonin.

Nëna e Aliut e kishte vënë re këtë dhe i kishte folur shpesh. Por fjalët e saj hynin në njërin vesh të Aliut dhe dilnin nga veshi tjetër. Tashmë kishte ardhur koha t'i jepte fund kësaj gjendjeje, sepse djali i saj nuk po e kuptonte vlerën e kohës dhe po i kalonte pushimet pa bërë asgjë. Për këtë arsye mori në dorë një laps dhe një letër. E zhubrosi pakëz letrën që të dukej disi e vjetër dhe mbi të vizatoi një hartë. Pastaj e thirri Aliun dhe i pëshpëriti fshehurazi në vesh: "Ali, ka ardhur koha që të të tregoj edhe ty..."



Aliu u bë kureshtar. U afrua edhe më shumë nga nëna dhe filloi ta dëgjonte me shumë vëmendje.

"Do të të tregoj për thesarin e fshehur."

"Çfarë!.. Thesar?!.. Po ku është?.."

"Po, një thesar... Është i fshehur në sënduk..."

Tashmë edhe Aliu po fliste me zë të ulët:

"Ku ndodhet ky sënduk?"

Nëna i zgjati hartën që mbante në dorë dhe i tha:

"Ja ku e ke të vizatuar... Thesari gjendet në kopshtin e shtëpisë dhe të takon ty ta gjesh atë."

Aliu shikonte i shastisur hartën. Pak më vonë vendin e shastisjes e zuri emocioni dhe shpresa... Duhet të thërriste menjëherë shokët, me ta të bënte një mbledhje. Doli nga shtëpia duke vrapuar.

Në një kohë të shkurtër Aliu dhe shokët e tij ishin mbledhur në kopshtin e shtëpisë. Analizonin hartën dhe flisnin për të. Emocioni dhe shpresa u lexohej në sy.

"Këtu është dera e jashtme... Ec dhjetë hapa... Pastaj pesëmbëdhjetë hapa majtas...Kthehu tërthor, pastaj bëj edhe tetë hapa të tjerë..."

Aliu u nis i pari. Shokët e ndiqnin hap pas hapi, sipas treguesve në hartë.

" Edhe dy hapa dhe ja... Duhet të jetë poshtë

kësaj pemës!"

Të gjithë bashkë filluan të gërmonin poshtë pemës. Pas shumë mundimesh, u shfaq një kuti.

"Ja tek është! E gjetëm thesarin, shokë!" – u dëgjuan ca zëra.

E nxorën kutinë me kujdes. Fshinë dheun që e mbulonte. U habitën shumë, kur panë se ajo ishte e mbyllur me një kyç të madh. Domethënë tani duhet të gjenin edhe çelësin. Aliu vrapoi te nëna dhe i tha:

"E gjetëm thesarin, nënë! Por sënduku ishte i kyçur. Ku mund të jetë çelësi?"

Nëna e tij u ngrit qetësisht, hapi sirtarin dhe nxori nga aty një letër.

"Ja, çelësi është i fshehur në këtë gjëagjëzën këtu!"

Aliu mori letrën dhe shkoi me të shpejtë te shokët. U lexoi gjëagjëzën:

"Kohën mos e harxho kot, dija vlerën thesarit! E ç'është në të vërtet një thesar? Duhet të mendohet mirë. Ari, paraja e pasuria janë të përkohshme në këtë botë...Në kuti është gjëja më e çmuar, por ç'ti bësh që edhe ajo është e kyçur. Vendi i çelësit është i qartë, e kundërta e vendit që po shikon..."



Aliu dhe shokët e tij vendosën të mendonin për gjëagjëzën dhe të takoheshin sërish të nesërmen. Ky ishte një sekret, dhe askush tjetër nuk duhet ta dinte. Të nesërmen shkuan sërish te vendi, ku gjetën kutinë. Ndërkohë që po shikonin vendin, ku gjetën kutinë, Aliu lexoi edhe njëherë gjëagjëzën. Kur tha "Vendi i çelësit është i qartë, e kundërta e vendit që po shikon", i shkëlqyen sytë:

"E gjeta!", - tha. "Thotë e kundërta e vendit që po shikon. Nga po shoh unë? Nga gropa, domethënë poshtë! Duhet të jetë sipër nesh. Ejani, pra shokë, të kërkojmë lart!"

Në degën e pemës së vogël panë diçka që shkëlqente. Po, aty qëndronte i varur çelësi. U dëgjuan zërat e tyre të gëzuar. Tashmë çelësi ishte gjetur, kutia do të hapej dhe ata do të shihnin thesarin. Aliu mori në dorë kutinë, hapi kyçin me çelës dhe ngriti ngadalë kapakun e kutisë. Nuk u besuan syve.

Nuk prisnin aspak një gjë të tillë. Çfarë thesari qenka ky?! Kishin mbetur të habitur, sepse në sënduk ishte një orë e vjetër dhe një copë letër. Ky na paska qenë thesari i çmuar?!.. Ndërsa ata, kur kishin dëgjuar fjalën thesar, çfarë nuk kishin menduar... I zhgënjyer Aliu mori në dorë orën dhe letrën, pastaj filloi të lexonte:

"Koha rrjedh e ikën pa ndalur.
Prandaj, të lutem, kot mos e harxho.
Puno pa ndalur edhe ti!
Koha kalon, s'e kupton se si...
Vlerësoje kohën Ali i nderuar!
Çfarë të punosh, ke për të kujtuar...
Asnjëri nuk nxirrte zë. Menduan pak dhe e kuptuan të gjithë mesazhin. Kishte ditë që mundoheshin për këtë, dhe nuk e kishin kuptuar se si koha kishte kaluar. Thesari që gjetën ishte me të vërtetë i çmuar. Aliu mori orën dhe vrapoi për te nëna:

"Mami... E gjetëm thesarin!"

Nëna i ledhatoi kokën, i buzëqeshi, pastaj i tha:

"Djali im është shumë i zgjuar... Myslimani nuk e çon kurrë kohën dëm, apo jo bir? Të mos e harrojmë hadithin fisnik në të cilin Pejgamberi (a.s.), thotë: "Dy mirësi shumica e njerëzve nuk i kanë shfrytëzuar siç duhet: shëndetin dhe kohën."

"Po, mami... Isha zhytur aq shumë në imagjinata të kota, saqë nuk po e kuptoja se po e harxhoja kohën kot."

Aliu e kuptoi gabimin dhe në një kohë të shkurtër e mblodhi veten dhe filloi ta kalonte kohën me punë të ndryshme e të mira.





# Kush e gjen, le ta thotë...

1.
Një ari,
Një patok
Një cironkë,
Një maçok,
Sa këmbë kanë të gjithë tok?

2.
Ka mustaqe,
Po s'është burrë,
Ka dhe thonj,
Po s'i pret kurrë.
Ka lëkurë,
S'i duhen rroba
I pëlqen
Të flerë te soba.

3.
Gojë ka, po nuk ka dhëmbë
E ka trupin plot me pendë,
Ha e pi, fle në kotec,
Po ç'e do... s'bën asnjë vezë.

4.
Lopa bëri qengj bardhosh,
Delja bëri viç larosh,
Ndërsa pula bëri kec,
Kec të vogël, grindavec.
Dhia ngrohu dhjetë vezë
Edhe nxori zogj të zezë.

Fjalët, duke shkruar
Më janë ngatërruar,
Ju që po lexoni
Shpejt i rregulloni.

Tasim Gjokutaj




# SHPORTA ME TRËNDAFILA

Në një natë të bukur Ramazani, në kohën e iftarit, pasaniku "i varfër" i dhuroi një shportë me ushqime të prishura një endacaku, që po lypte tek dera e xhamisë. Endacaku, me buzëqeshje të ëmbël, e pranoi dhuratën e pasanikut dhe e falënderoi për "zemërgjerësinë" e tij…

Kur u kthye në shtëpi, i hoqi ushqimet një nga një, pastroi shportën dhe e mbushi plot me trëndafila të kuq.

Të nesërmen, në kohën e iftarit, endacaku po priste te dera e xhamisë. Nuk vonoi shumë dhe erdhi pasaniku "i varfër". Endacaku e priti duke i thënë "Urdhëroni zotëri, kjo shportë është një dhuratë modeste për ju!" Pasaniku u habit dhe e pyeti: "Përse? Si është e mundur?!.. Mbrëmë dhurova një shportë me ushqime të prishura dhe sot po ma ktheni përsëri atë shportë të mbushur me trëndafila!.. Kjo s'më… ka ndodhur asnjëherë… Nuk e prisja…"

Endacaku vuri buzën në gaz e i tha: "Zotëri! Çdo njeri dhuron atë që ka në zemër."

**Përgatiti: Gilman Kazazi**



- tregim humoristik -



# MEMISHXHANI

Ekrem Bektash

## NËSE SI DHURATË DO NJË BIÇIKLETË, NË TË GJITHA MËSIMET TË KESH NOTËN DHJETË

Përshëndetje miq! Unë jam Memishxhani... Memishxhani, që nuk di se çfarë bën e si vepron... Në fakt, unë, e di shumë mirë se çfarë bëj dhe ata që nuk e dinë këtë, janë kundra meje.

Ndonëse është vështirë të ndjesh ngrohtësinë e dëshirës të verës në këto ditë të para të muajit mars, unë pothuajse po fluturoj mbi biçikletën që ma ka premtuar babai...

"Ja dëftesa, baba!" - do t'i them "Ku është biçikleta?"

Ky premtim që deri tani është shtyrë për shkaqe të ndryshme, këtë verë do të përmbushet dhe Memishxhani do të hipë mbi biçikletën e tij.

Kurrë nuk kam pasur një biçikletë... T'i jap asaj kam mësuar në biçikletën e Agronit. Ju do të thoni se Agroni nuk lë as babanë të hipë në biçikletën e tij, por sigurisht se çdo gjë e ka një shpagim.



**Myzoja: Në Meksikë të gjithë hipnin në biçikleta.**
**Memishxhan: Ti thoshe se hipnin në gomar!**
**Myzoja: Meksikanët biçikletës i thonë gomar.**

Ishte viti kur ne ishim në klasën e dytë... Një ditë, Agronit papritur i humbi çanta... Ai erdhi menjëherë te unë... Ai që jam sot isha dhe atëherë... Po ashtu dhe Agroni nuk ka ndryshuar aspak...

"Më ka humbur çanta!.." - më tha. Sikur donte të më thoshte "Mos e ke marrë ti?", por ngurroi dhe fjala i mbeti përgjysmë...

"Ndoshta ndonjë shok ka dashur të bëjë shaka." - i thashë.

"Mos vallë ti?.."

"Nga e nxore këtë tani?"

"Po ti the që shoku yt të ka bërë shaka!"

"Po ne nuk jemi shokë... Ti as biçikletën nuk ma jep asnjëherë të bëj një xhiro me të..."

"Mirë!" - tha. "Nëse më gjen çantën, ta jap të bësh një xhiro!"

"Në rregull edhe kjo punë." - thashë me vete dhe dola para klasës.

"Shokë! Ka humbur çanta e shokut tonë Agronit. Kushdo që e ka marrë, le ta sjellë!"

Myzoja erdhi para klasës me një çantë të kuqe në dorë duke thënë:

"Këtu është një çantë e huaj."

Agroni në fillim u gëzua... Pastaj tha: "Po çanta ime është e zezë!.." Në atë çast erdhi një nxënës nga klasa tjetër me një çantë të zezë në duar dhe tha:

"Kam ngatërruar çantën time me të dikujt tjetër."

Agronit i shkëlqyen sytë dhe bërtiti : "Është çanta ime!"

Djali ia dha çantën atij dhe mori nga Myzoja çantën e tij. Ndërkohë Agroni kishte ngelur si i shastisur...

Si mund të ngatërrohej një çantë e zezë me një të kuqe?

"Epo, qenkeni ngatërruar dhe askush s'ka faj për këtë. Rëndësi ka që çanta u gjet!"

## ÇFARË XHIROJE ËSHTË KJO, GJITHË DITËN MOS NDALO...

Të nesërmen ishte e shtunë... Ishte dita kur unë do të bëja xhiron me biçikletë. Agroni e solli biçikletën e tij me fytyrë të varur dhe pa aspak dëshirë... Ç'të bënte që më kishte dhënë fjalën meqë i gjeta çantën... Në fakt Myzoja e njihte djalin me të cilin ngatërruan çantat... Ndërsa unë bëra planin... Sot unë do të mësoja t'i jepja biçikletës... Myzoja e dinte këtë... Vëllai i tij i madh kishte biçikletë, ndërsa unë nuk kam vëlla, kështu që nuk kam as biçikletë...

Agroni ma dha biçikletën duke iu dridhur dora, pastaj tha duke iu dridhur buza:

"Vetëm një xhiro-ë!"

"Në rregull, vetëm një xhiro!"

Hipa në biçikletë... Myzoja më mbajti... Morëm kthesën dhe u zhdukëm!..

Agroni na priti deri në mbrëmje... Lëvizi rreth e rrotull dhe përplasi këmbët nga inati... Pyeti çdonjërin që kaloi për ne...

Atë ditë deri në mbrëmje e mësova biçikletën, madje edhe Myzoja bëri xhiro me të... Nuk thonë kot "Kush hip në biçikletën e huaj, nuk di të zbresë!" Edhe ne në mbrëmje ia sollëm atë të zotit...

Agroni po qante nga inati.

"Pusho!" - i thashë. "Një xhiro bëra, dhe ja ta solla!"

"Çfarë xhiroje është kjo? Gjithë ditën..."

"Po ne nuk e caktuam llojin e xhiros... Ka xhiro Botërore, Evropiane dhe të vendit... Madje ne nuk e zgjatëm shumë. Shkuam deri në fund të lagjes dhe erdhëm...

Agroni nuk mundi të thoshte asgjë... Ndoshta u gëzua ngaqë nuk kishim bërë xhiron Botërore. Mori biçikletën dhe iku...


Tani që kisha mësuar t'i jepja biçikletës, bridhja me të edhe në ëndrra... Ndonjëherë bëja xhiron e Botës, ndonjëherë atë të Evropës...

Fundi i vitit shkollor afroi... Ishin ditët e fundit të Majit. Shkuam të gjithë bashkë në piknik... Ishte një vend pyjor... Kishte edhe rrugë ku mund të ecje me biçikletë. Herë tjetër, ndoshta, mund të vij me biçikletën time... Të shëtis gjithë qejf në rrugët e pyllit me ajër të pastër... Sepse babai vetëm në vende si këto mund të më lejojë t'i jap biçikletës dhe asnjëherë në vende, ku ka trafik...

## BËJ KUJDES, MOS U RRËZO! SHTYPI FRENAT DHE NDALO!..

Pylli filloi të errësohej... Filluan të shumoheshin pemët e errëta... Ngado që shkoja, errësira shtohej... Mesa dukej kishte rënë mbrëmja...

"Bobo!" - thashë me vete... Po humbisja rrugën... Kisha frikë edhe të thërrisja për ndihmë, sepse kafshët



**- Xhaxhi Saxhit, a kishe biçikletë kur ishe i vogël?**
**- Kisha një biçikletë me tre rrota.**
**- Po pastaj, çfarë ndodhi?..**
**- Pastaj unë u rrita, ndërsa ajo jo...**

e egra të pyllit mund të dëgjonin zërin tim dhe të vinin e të më hanin...

Po të kisha biçikletë, ndoshta do ta gjeja më shpejt rrugën... Do të ndizja dritën e saj dhe rruga do të ndriçohej...

Frika po më shtohej... Fillova të dridhesha... Me sa dukej këtë natë do ta kaloja në stomakun e ndonjë ariu... Papritur më doli para një ari... Nuk më dha aspak kohë të frikësohesha, sepse filloi të më buzëqeshte...

"Kam humbur më duket..." – tha.

"Po, por ti e di gjuhën tonë!"

"Për vite me radhë kam punuar në një cirk... E kam mësuar atje gjuhën. Tani kam dalë në pension dhe po e shijoj, në këtë pyll të qetë..."

"Kur shkova njëherë në cirk, pashë atje një ari që bënte akrobaci mbi biçikletë."

"Po... Ai kam qenë unë... Eja të të hip në biçikletë dhe të të çoj në shtëpi... Prindërit e tu do të jenë bërë merak për ty..."

U gëzova shumë... Ariu nxori menjëherë biçikletën nga barku...

Hipa pas tij... Ai shtypi pedalin... Sikur po fluturonim...

Dhe me të vërtetë fluturuam:

"A nuk ka frena kjo?" - e pyeta.

"Jo, nuk ka. Për të frenuar ne duhet të thërrasim "freeena! - Gati: një, dy, tre...

"Freeenaa!"

Papritur u përplasëm diku... E gjeta veten përtokë... Mami erdhi sapo dëgjoi zërin tim... Kisha rënë nga shtrati... Kushedi edhe në sa ëndrra të tjera do të bredh kështu... Tani mirëmbetëshi miqtë e mi të shtrenjtë...

# PSE NËNA IME NUK ËSHTË MAGJISTARE?


**Hymejra Karagëz**

Shumica prej nesh, kur ka kohë të lirë shikon filma e telenovela, apo jo? Një nga llojet e filmave që iu tërheq më shumë se të tjerët është ai me magji dhe me heronj që kanë super-fuqi... A nuk është kështu? Në qoftë se përgjigja juaj është pozitive, po vazhdoj me bisedën...

Ju jeni më fatlumë se të mëdhenjtë në disa tema. Si fillim, ju keni një imagjinatë shumë të zhvilluar... Ju jeni shumë të aftë për të prodhuar ide të reja dhe të veçanta, që na çudisin ne të rriturve. Nga ana tjetër ju bëni përpjekje serioze për të realizuar idetë tuaja origjinale.

Ju jeni shumë të pafajshëm, miqtë e mi të vegjël. Keni një naivitet të veçantë. Ne e harrojmë këtë gjë dhe pa dashje e shkatërrojmë. Ai besim i pastër që keni, ju ndihmon të mendoni dhe të formoni karakterin tuaj. Naiviteti fëminor është dhurata më e bukur që ju është bërë.

Pikërisht në këtë temë ne të rriturit bëjmë shumë gabime. E harrojmë këtë cilësi tuajën dhe e shkatërrojmë. Pse? Sepse ne biem rob të telenovelave dhe filmave me heronj magjikë dhe me super-fuqi. Këto prodhime të kinemasë na largojnë krejtësisht nga jeta reale. Ato e shkatërrojnë imagjinatën dhe produktivitetin e trurit. Pas një farë kohe, ne nuk mundemi të ëndërrojmë, të mendojmë dhe të bëjmë përpjekje për të realizuar qëllimet tona. E vetmja gjë tek e cila na rri mendja është një magji që



do të na realizonte ëndrrat.

Fillojmë që të pyesim nënat dhe motrat tona më të mëdha: "Po ti pse nuk ke fuqi magjibërëse?" Po ne e dimë shumë mirë që magjia nuk ekziston... Edhe vetë aktorët dhe regjisorët e dinë shumë mirë që magjia nuk ekziston... A nuk është për të ardhur keq që pavarësisht kësaj, ata përpiqen t'i bindin njerëzit që magjia është e mundur?..

Miq të dashur, ata filma nuk bëjnë gjë tjetër, veçse na mësojnë të jemi dembel. Ne nuk e kuptojmë por ata janë shumë të dëmshëm për psikologjinë tonë. Ku është parë që të lëvizin gjërat nga vendi vetëm me një lëvizje dore? Ne jemi njerëz. Nuk jemi shtriga dhe magjistarë... Ne duhet të derdhim djersë për të arritur qëllimet tona në jetë. Asgjë nuk vjen me një magji të thjeshtë... Duhet të besojmë dhe të punojmë për të realizuar ëndrrat tona. Në cilën periudhë të njerëzimit janë arritur idealet pa bërë asnjë gjë? Duhet ta kuptojmë mirë që vetëm pula ka sukses duke qëndruar ulur... Ne nuk jemi pula, prandaj duhet të punojmë me vullnet për gjërat që duam.

Ne jemi fëmijë të familjeve myslimane. Kurani Kerim e ka shpjeguar magjinë si një mashtrim. Nuk duhet të gënjehemi nga bukuria e telenovelave dhe e filmave që kanë për bazë këtë temë. Duhet të mendojmë e të pyesim: Pse kemi ardhur në këtë botë? Pse Allahu na krijoi si më të lartët e të gjitha krijesave? Pse na dha mendje? Duhet të përdorim mendjen dhe të jetojmë një jetë në përputhje me rregullat e Islamit. Ne duhet të bëjmë përpjekje për të qenë rob të denjë të Allahut (xh.sh)...

Ju të gjithë keni një super-fuqi shumë të veçantë! Kjo fuqi ia kalon të gjithë fuqive që propagandohen në filma e telenovela... Ajo është fuqia e lutjes, Duasë... Ajo është fuqia më e madhe që na ka dhënë Krijuesi ynë. Ju punoni me aq sa keni mundësi dhe pastaj lëreni në dorë të Allahut. Lutuni Allahut... Atëherë do ta kuptoni më mirë fuqinë e Duasë... Do të kuptoni se nuk ka asnjë super-fuqi që t'ia kalojë asaj...



Mos vallë përsëri jeni duke u ankuar që nëna juaj nuk di të bëj magji? Akoma nuk e keni kuptuar se ajo është më e fuqishme se nënat e filmave me magji... Ajo ka një forcë që nuk krahasohet me asgjë tjetër!.. Ju keni një nënë myslimane... Ta dini që lutjet e një nëne myslimane nuk refuzohen asnjëherë! Ajo është nënë, motër dhe shoqja juaj më e madhe... Ajo ka një fuqi të tillë që vetëm me një DUÂ të vogël mund t'jua zbukurojë jetën! Përsëri ankoheni pse nuk keni një nënë magjistare? Përgjigjja është para jush... Dua-ja është super-fuqia e nënave myslimane dhe ajo është fuqia më e madhe në botë...

Tani që e kuptuat fuqinë që mbani brenda jush, përdoreni me mençuri... Le të fillojë koha e të bërit Dua të sinqerta Krijuesit tonë...

Dijeni mirë që jeni gjithmonë në Duatë e mia!...

# MOLLA KUQALOSHE DHE KRIMBI KURRIZGJELBËR

Krimbi kurrizgjelbër ecte, zgjatej e zvogëlohej; zvogëlohej, zgjatej dhe ecte…

Në këtë çast, përralla na thotë, se krimbi është duke ecur… Prapë zgjatet, prapë zvogëlohet, prapë ec, prapë e prapë…

Krimbi edhe pse është krimb, ëndërron!.. Dëshiron të ketë jo një ditë, por shumë ditë të lumtura!.. Dhe… zgjatet, dhe… zvogëlohet… Kështu i kërkon ato ditë të ëndërruara!..

Përralla na thotë, se është mëngjes, dhe se krimbi u nis për të kërkuar ditën e tij më të lumtur…

Udhëtoi e udhëtoi… Herë fshehurazi e herë zbuluar. Herë dinak e herë paqësor. Herë i urtë e herë agresiv. Herë gojëmbël e herë gojëhidhur. Eci e eci… ngadalë e ngadalë… Në fillim përgjatë një trungu relievashpër tërë kujdes për të mos u rrëzuar. Më pas shëtiti gëzueshëm përmes një fushe me gjethe të gjelbra, si një triumfator. Gjelbërimi, sikur ia shtonte energjitë krimbit kurrizgjelbër. E bënte të ecte më shpejt. I dhuronte buzëqeshje të gjelbërta. Kështu, ndjeu aromën dehëse të gjelbrimit dhe u ngop siç ngopen krimbat!.. Ç'them?.. Krimbat nuk ngopen kurrë. Krimbat janë grykës. I tillë është dhe krimbi i përrallës sonë. I shkoi goja lëng, kur diktoi faqen e kuqe të një molle, të cilën dy gjethe nuk e kishin fshehur krejt. Sa e bukur dukej!.. Krimbi eci dhe pak… Eci dhe pak e pa u ndjerë. E qëndroi para faqes kuqluese të mollës. E tundoi ajo! Sikur ia bënte me sy. E krimbi si përgjigje, nuk vonoi dhe e thumboi një herë. Priti. E thumboi dy herë… Ngaqë i pëlqeu thumbimi, e bëri disa herë. Ohoho, sa lëng thithi!.. I pëlqeu lëngu i saj. Ishte i ëmbël dhe i shijshëm!..

Molla nuk ndenji indiferente. U mundua të mënjanohej, të lëkundej si një lavjerrës ore, por pa dobi. Pickimet që nuk i duronte, i sollën dhembje, e dhembje të mëdha.

-Përse ma gërvisht faqen? Ç'të kam bërë?!.., - pyeti molla e mërzitur.

-Asgjë. – u përgjigj krimbi. -Por faqja jote më ngjan si një fletë e kuqe dhe unë kam dëshirë të vizatoj…



-Mos jeni piktor?!..


-Jo.

-Atëherë, ç'je ti që më shkakton dhembje në faqe? – ia ktheu molla dhe nisi të zbehej në fytyrë.

-Unë jam një zhgarravitës. Këtë punë di të bëj. E ndërtoj lumturinë time, duke prishur lumturinë e të tjerëve. Dhe kjo është dita më e lumtur e jetës sime!..

Fjalët e krimbura të krimbit kurrizgjelbër i dëgjoi era që po frynte në atë çast. Ajo u zemërua aq shumë, sa ca gjethe të gjelbra i shndërroi në shuplaka të vogla, të cilat filluan të qëllonin krimbin e vogël, pa pushim. Ai nisi të mbrohej, duke u zvogëluar e duke u zvogëluar... Atëherë era i zemëroi edhe më shumë gjethet, sa krimbi nuk u bëri dot ballë, u rrëzua dhe humbi rrugën...

Edhe pse krimbi s'u pa më, molla ende ndiente dhembje në faqe. I digjte faqja! Kur u pa në një pasqyrë të një gjetheje ku kishin mbetur disa pika vese, i shpëtuan ca pika loti. Ç'të shikonte!.. Krimbi ia kishte shëmtuar faqen!..



- Obobooo!.. Si mund t'i heqë këto vija shtrembaluqe! Si do t'i dal para diellit e vogëlushit me këtë faqe!.. Obobooo! Obobooo!.. Si do të shkojë halli im! Dua të shërohem!..

-Mos u mërzit mollë, se do të shërohesh..., – ndërhyri me të shpejtë dielli, që kishte ardhur mysafir në pyll.

Molla mbeti e habitur dhe u mundua përmes një gjetheje të fshihte faqen e zhgarravitur.

-Mollë, mos u trishto! Ti je e bukur, kuqaloshe, - i tha dielli.

-Unë...

Molla ndjeu njëherësh ngrohtësinë e rrezeve flokarta. Ata kishin marrë me vete dhe ca re të bardha, të cilat ngjanin si infermiere dhe së bashku me rrezet flokarta nisën t'ia mjekonin faqen mollës.

-Kujdes... – tha një rreze.

-Pak fashë... – tha një re.

-Ngjite mirë... – foli një rreze.

-Mos lëviz! Duro! Operacioni është i lehtë! – foli një re.

-Do të ndjesh pak dhembje, - ia priti një rreze.

-Të nesërmen mollë, faqen do ta kesh si mollë. – ia priti një re.

Kur u larguan, i thanë:

-Mollë lëngëmbël, çdo ditë, e pak nga pak, e pak nga pak, do të kuqëlosh si më parë!..

Molla nuk i harroi fjalët e rrezeve flokarta dhe reve pastërtore. Pas ca ditësh, përsëri, u pa në pasqyrën e një gjetheje, ku kishte më shumë pika vese. Ç'të shikonte!.. Sikur... nuk i besonte pamjes që po shihte! Faqja ishte shëruar, kuqëlonte dhe ishte e bukur si më parë!..

-Ah! – pëshpëriti me vete e kënaqur molla. – Kjo është një ditë e lumtur!

Molla thirri erën. Era erdhi si një fllad i lehtë. Ia lëmoi faqet. Ia përkëdheli disa herë...

-Më thuaj, çfarë do?.. – pyeti erafllad.

-Të lutem, kudo që të shkosh, shpërndaje aromën time prej molleje. Mos harro diellin rrezeartë dhe retë pastërtore!

Flladi, si një postier këmbëshpejtë, gjithandej, shpërndante ftesa, kësaj here me aromë molle...

Leon N. Tolstoi

# KAFSHA E MIRË DHE KAFSHA E KEQE

Një miush kishte dalë për të shëtitur. Ai u end sa andej-këtej në oborr dhe u kthye përsëri tek e ëma.

-E di ti, nënokja ime, unë kam parë sot dy kafshë. Një të keqe dhe një të mirë.

E ëma e pyeti: "Po ç'pamje kishin këto dy kafshë?"

Miushi u përgjigj: "Kafsha mizore ecte nëpër oborr lart e poshtë dhe kishte këmbë të zeza, një balluke të kuqe, sy të ndezur dhe një hundë të harkuar. Kur unë kalova para tij, ai e shqeu fytin, ngriti njërën këmbë dhe ulëriti aq shumë, saqë unë nga frika, nuk po dija se ku të futesha.



-Ky ka qenë gjeli, - e sqaroi miushja. – Ai askujt nuk i bën keq. Prej tij nuk duhet të kesh frikë. Po kafsha tjetër si ishte?

-Kafsha tjetër ishte shtrirë e ngrohej në diell. Kishte një qafë të bardhë, shputa gri të buta, të vogla, lëpinte gjoksin e vet të bardhë dhe lëvizi pakëz bishtin, kur më pa mua.

Atëherë miushja mëmë i tha:

-Ah, mor budalla, budalla i vogël! Po ajo ka qenë macja.



# BUJKU DHE FËMIJËT E TIJ

Punoni, mundohuni, ky është thesari më i sigurt.

Një ditë një bujk i kamur, duke ndier vdekjen e tij të afërt, thirri fëmijët e tij dhe u foli pa dëshmitar:

-Ruajuni se mos shisni tokën, të cilën na e kanë lënë të parët tanë, në të është fshehur një thesar. Unë nuk ia di vendin, por me pak guxim ju keni për ta gjetur dhe keni për t'ia arritur qëllimit. Me të hyrë gushti, bëjini arës një qilizmë të mirë; gërmoni, kërkoni, kthejeni me bel, mos lini asnjë vend ku të mos kalojë e rikalojë dora juaj.

Me të vdekur babai, të bijtë e kthyen arën përmbys, këndej e andej, nga të gjitha anët, kaq mirë saqë në fund të vitit ajo dha një prodhim të madh. Por asnjë para e fshehur nuk u gjet.

Mos harroni se babai u tregua i mençur, sepse ai para se të vdiste, u tregoi të bijve që puna është thesar.





# SUPER ZBAVITJE










## NGJYROS ARUSHIN

## 7 NDRYSHIMET





Gjeni se cila prej alternativave i përshtatet fotos!



Duke u bazuar në foton e dhënë
dhe në ndihmën e pjesshme të kutizave,
gjeni fjalën e urtë!


| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| D | | | | | | | | | |
| | A | | I | T | | N | | | |
| E | | U | N | | | S | | N | |
| | N | | | E | N | | | | |



Katrorin ndaje në katër pjesë të barabarta në mënyrë që çdo pjesë të ketë nga tre yje.



Në secilën formë brenda katrorëve të vegjël fshihet një shifër. Duke mbledhur çdo rresht dhe çdo kolonë përftojmë numrat jashtë katrorit të madh. Gjeni se cila nga format duhet në katrorin bosh.




16
10
17
20

12 21 18 12



Bretkosa do që të shkojë
pranë shoqes së saj.
Ndihmojeni të gjejë rrugën.







# NASTRADINI


Heu, ja ku po vjen Nastradin Hoxha! Le të argëtohem pak me të!
Hoxhë, këtë gomar e ngarkon aq shumë, sa do të vijë një ditë dhe s'do të mund të mbajë më, atëherë si do t'ia bësh?
Marr një gomar të ri dhe këtë e lëshoj të vejë ku të dojë.
Hoxhë, kjo është padrejtësi, si e lëshon gomarin e kaq viteve dhe merr një gomar të ri. A nuk të zemërohet ai ty?
Po ku ka gomar që mendon kaq mirë sa ti, mor bir?!

# Lagjja Jonë


HAJDE KUNGUJ, DOMATE, PATËLLXHANË...
Ou, gomari i paska shportat bosh, përse thërret kot?
Ç'të bëj! Lagjja m'i ka marrë perimet veresie dhe shportat kanë mbetur bosh.
Meqë shportat i ke bosh, përse sillesh kot?
Unë mbeta që mbeta pa punë, thashë të mos e lë edhe gomarin pa punë...
Meqë është ashtu puna, të paktën mos bërtit!
Gomari im është i zgjuar, nëse nuk thërras, fillon e dyshon...
Ke të drejtë, në këtë lagje vetëm njëri është i zgjuar, dhe ai është gomari yt.

# Së shpejti në dorën tuaj...







